



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr.101/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përbarimore të kreditorit “Majanca” SH.P.K., me NUI: 811400928, me seli në rr. “Veternik” Nr. N-25.2, në Prishtinë, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson J.I., avokat nga Prishtina, kundër debitorit N.P. Izolimi (Halit Rama B.I.), me seli në rr. Përroi i Njelmët, me NUI: 810445941, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përbarimor P.nr.707/22 të datës 27.12.2022, të Përbaruesit Privat Rezarta Metaj, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 31.07.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit N.P. IZOLIMI (HALIT RAMA B.I.), dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri Përbarimor P.nr.707/22 i datës 27.12.2022, i Përbaruesit Privat Rezarta Metaj për pjesën e detyrimit në shumën prej 75.00 € (shtatëdhjetë e pesë euro), sipas Faturës Nr: 211-210-VT1-17 të datës 18.10.2017.
- II. REFUZOHET PJESËRISHT si i pabazuar prapësimi i debitorit N.P. IZOLIMI (HALIT RAMA B.I.), dhe MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përbarimor P.nr.707/22 të datës 27.12.2022, të Përbaruesit Privat Rezarta Metaj sa i përket shumës prej 8,736.84 € (tetë mijë e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë euro e tetëdhjetë e katër cent), së bashku me kumatën ligjore sipas normës së interesit vjetor prej 8%.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përbarimore e kreditorit “MAJANCA” SH.P.K., ndaj debitorit N.P. IZOLIMI (HALIT RAMA B.I.), sipas urdhrit P.nr.707/22 të datës 27.12.2022, për shumën prej 75.00 € (katërdhjetë e katër euro e njëzet cent), sipas Faturës Nr: 211-210-VT1-17 të datës 18.10.2017.

## A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.707/22 të datës 27.12.2022, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 1456-210-MA1-21 të datës 13.11.2021; Faturës Nr. 1413-210-MA1-21 të datës 06.11.2021; Faturës Nr. 679-210-MA1-20 të datës 08.07.2020; Faturës Nr. 778-210-MA1-20 të datës 29.07.2020; Faturës Nr. 632-210-MA1-20 të datës 27.06.2020; Faturës Nr. 587-210-MA1-20 të datës 18.06.2020; Faturës Nr. 481-210-MA1-20 të datës 28.05.2020; Faturës Nr. 387-210-MA1-20 të datës 07.05.2020; Faturës Nr. 278-210-MA1-18 të datës 18.09.2018; Faturës Nr. 266-210-MA1-18 të datës 10.09.2018; Faturës Nr. 260-210-MA1-18 të datës 03.09.2018; Faturës Nr. 250-210-VT1-17 të datës 18.11.2017; Faturës Nr. 244-210-VT1-17 të datës 17.11.2017; Faturës Nr. 236-210-VT1-17 të datës 09.11.2017; Faturës Nr. 228-210-VT1-17 të datës 02.11.2017; Faturës Nr. 226-210-VT1-17 të datës 02.11.2017; Faturës Nr. 227-210-VT1-17 të datës 02.11.2017; Faturës Nr. 217-210-VT1-17 të datës 27.10.2017; Faturës Nr. 215-210-VT1-17 të datës 20.10.2017; Faturës Nr. 214-210-VT1-17 të datës 20.10.2017; Faturës Nr. 212-210-VT1-17 të datës 18.10.2017; Faturës Nr. 211-210-VT1-17 të datës 18.10.2017; Faturës Nr. 207-210-VT1-17 të datës 16.10.2017; Faturës Nr. 153-210-MA1-17 të datës 04.10.2017; Faturës Nr. 197-210-VT1-17 të datës 03.10.2017; Faturës Nr. 151-210-MA1-17 të datës 03.10.2017; Faturës Nr. 196-210-VT1-17 të datës 02.10.2017; Faturës Nr. 149-210-MA1-17 të datës 02.10.2017; Faturës Nr. 148-210-MA1-17 të datës 30.09.2017; Faturës Nr. 194-210-VT1-17 të datës 27.09.2017; Faturës Nr. 191-210-VT1-17 të datës 25.09.2017; Faturës Nr. 190-210-VT1-17 të datës 23.09.2017; Faturës Nr. 185-210-VT1-17 të datës 22.09.2017; Faturës Nr. 182-210-VT1-17 të datës 15.09.2017; Faturës Nr. 176-210-VT1-17 të datës 07.09.2017; Faturës Nr. 174-210-VT1-17 të datës 06.09.2017; Faturës Nr. 167-210-VT1-17 të datës 30.08.2017; Faturës Nr. 161-210-VT1-17 të datës 25.08.2017; Faturës Nr. 99-210-MA1-17 të datës 04.08.2017; Faturës Nr. 139-210-VT1-17 të datës 21.07.2017 dhe Faturës Nr. 85-210-MA1-17 të datës 10.07.2017, duke urdhëruar debitorin që t'ia paguaj kreditorit shumën prej 8,811.84 €, me kamatë ligjore prej 8%, deri në pagesën definitive të borxhit kryesor, si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës në llogarinë e veçantë të përmbaruesit privat, si dhe me regjistrimin, vlerësimin, sekuestrimin dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit.

Debitori në prapësimin e paraqitur brenda afatit ligjor, ka deklaruar se e kundërshton këtë urdhër për përmbaerim për shkak se dëshmitë e ofruara nuk paraqesin afatin e pritjes e cila ka qenë e definuar me marrëveshje mes palëve. Meqenëse përmbaeruesi privat ka lejuar përmbaerimin sipas ekstraktit të korrigjuar nga librat e kreditorit, i ka propozuar gjykatës që të aprovohet prapësimi i debitorit dhe të anulohen vendimet e kryera.

Kreditori, brenda afatit ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, duke i kundërshtuar në tërësi pretendimet e debitorit si të pabazuara duke theksuar ndër të tjerash se faturat në bazë të cilave është inicuar procedura përmbaerimore i plotëson të gjitha kushtet ligjore dhe si i tillë është dokument i përshtatshëm për përmbaerim. Në lidhje me pretendimin se përmbaerimi është inicuar sipas ekstraktit nga librat afarist nuk është e vërtetë, sepse kreditori ka inicuar procedurën në bazë të faturave origjinale të nënshkruara dhe të vulosura, ashtuqë qëllimi i debitorit është vetëm prolongimi i procedurës përmbaerimore. I ka propozuar gjykatës që të refuzohet si i pa bazuar prapësimi i debitorit, të mbetet në fuqi urdhri përmbaerimor si dhe të detyrohet debitori që në rast të ankesës të pagujë garancionin.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaerimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i pabazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbaerimor P.nr.707/22 i datës 27.12.2022, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas Faturës Nr: 211-210-VT1-17 të datës 18.10.2017, për shkak se kjo faturë nuk i plotëson kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së.

Gjykata gjeti se Fatura Nr.211-210-VT1-17 e datës 18.10.2017, nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se në rastin konkret nuk mund të vërtetohet që kjo faturë është pranuar në mënyrë të rregullt nga debitori, përkatësisht me asnjë provë nuk është dëshmuar se e njëjta është dorëzuar tek debitori, pasi që e njëjta nuk është e nënshkruar dhe as e vulosur nga ana e debitorit, dhe si e tillë nuk është e përshtatshme për përmbaerim.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit, duke lënë në fuqi pjesën tjetër të urdhrit P.nr.707/22 të datës 27.12.2022 për shumën në vlerë prej 8,736.84 €, për faktin se faturat në bazë të së cilave është lejuar urdhri për përmbnim, i plotësojnë kushtet për të qenë dokumente të besueshme dhe i përmbajnë të gjitha elementet e kërkuara, në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbnimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshatshëm për përmbnim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbnim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm ,sipas të cilit mund të caktohet përmbnimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbnuesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën Nr. 1456-210-MA1-21 të datës 13.11.2021; Faturën Nr. 1413-210-MA1-21 të datës 06.11.2021; Faturën Nr. 679-210-MA1-20 të datës 08.07.2020; Faturën Nr. 778-210-MA1-20 të datës 29.07.2020; Faturën Nr. 632-210-MA1-20 të datës 27.06.2020; Faturën Nr. 587-210-MA1-20 të datës 18.06.2020; Faturën Nr. 481-210-MA1-20 të datës 28.05.2020; Faturën Nr. 387-210-MA1-20 të datës 07.05.2020; Faturën Nr. 278-210-MA1-18 të datës 18.09.2018; Faturën Nr. 266-210-MA1-18 të datës 10.09.2018; Faturën Nr. 260-210-MA1-18 të datës 03.09.2018; Faturën Nr. 250-210-VT1-17 të datës 18.11.2017; Faturën Nr. 244-210-VT1-17 të datës 17.11.2017; Faturën Nr. 236-210-VT1-17 të datës 09.11.2017; Faturën Nr. 228-210-VT1-17 të datës 02.11.2017; Faturën Nr. 226-210-VT1-17 të datës 02.11.2017; Faturën Nr. 227-210-VT1-17 të datës 02.11.2017; Faturën Nr. 217-210-VT1-17 të datës 27.10.2017; Faturën Nr. 215-210-VT1-17 të datës 20.10.2017; Faturën Nr. 214-210-VT1-17 të datës 20.10.2017; Faturën Nr. 212-210-VT1-17 të datës 18.10.2017; Faturën Nr. 207-210-VT1-17 të datës 16.10.2017; Faturën Nr. 153-210-MA1-17 të datës 04.10.2017; Faturën Nr. 197-210-VT1-17 të datës 03.10.2017; Faturën Nr. 151-210-MA1-17 të datës 03.10.2017; Faturën Nr. 196-210-VT1-17 të datës 02.10.2017; Faturën Nr. 149-210-MA1-17 të datës 02.10.2017; Faturën Nr. 148-

210-MA1-17 të datës 30.09.2017; Faturën Nr. 194-210-VT1-17 të datës 27.09.2017; Faturën Nr. 191-210-VT1-17 të datës 25.09.2017; Faturën Nr. 190-210-VT1-17 të datës 23.09.2017; Faturën Nr. 185-210-VT1-17 të datës 22.09.2017; Faturën Nr. 182-210-VT1-17 të datës 15.09.2017; Faturën Nr. 176-210-VT1-17 të datës 07.09.2017; Faturën Nr. 174-210-VT1-17 të datës 06.09.2017; Faturën Nr. 167-210-VT1-17 të datës 30.08.2017; Faturën Nr. 161-210-VT1-17 të datës 25.08.2017; Faturën Nr. 99-210-MA1-17 të datës 04.08.2017; Faturën Nr. 139-210-VT1-17 të datës 21.07.2017 dhe Faturën Nr. 85-210-MA1-17 të datës 10.07.2017, të cilat i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këto fatura, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara shërbimet të cilat kanë qenë objekt i faturave, është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit si dhe koha e përmbushjes së këtij detyrimi dhe të njëjtat janë pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt.

Gjykata vlerësoi pretendimet e debitorit se në faturat e kreditorit nuk është treguar koha e përmbushjes së detyrimit monetar dhe gjeti se e njëjta nuk gjen mbështetje ligjore, sepse në rastin konkret këto fatura i plotësojnë kushtet e përcaktuara për zbatimin e përbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm për faktin se afati i përmbushjes së detyrimit është përcaktuar në secilën faturë. Për më tepër fatura e cila nuk përmban afat të përmbushjes nga data e lëshimit të faturës, nënkuptohet se afati për përmbushje arrin menjëherë respektivisht në datën e lëshimit të faturës.

Gjykata vendosi që të mbetet në fuqi urdhri i përbaruesit privat edhe në pjesën lidhur me kamatën prej 8%, dhe atë duke u bazuar në nenin 382 të LMD-së me të cilin përcaktohet se: *“Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”*, dhe vendosi si në pikën II të dispozitivit duke lënë në fuqi urdhrin përbarimor edhe sa i përket kësaj pjese, për faktin se debitori ka rënë në vonesë për përmbushjen e detyrimit në shumën prej 8,736.84 €, me çka rezulton se kreditorit i takon e drejta për kamatëvonesë lidhur me këtë shumë që nga momenti kur faturat janë bërë të arritshme për pagesë e deri në pagesën definitive.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përbarimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon*

*prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbarimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”, gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbarimit.*

Nga sa u tha më lart, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, duke u bazuar në nenin 71 dhe nenit 73 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, si dhe nenin 13 par.1 nën par. 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.

### GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë - Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.101/23, datë 31.07.2023

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

#### KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.